

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Akuzat për trafikim armësh/ Këlliçi: Të nisë menjëherë hetim parlamentar ndaj ministrit Nufi
ADRESA	https://www.cna.al/politike/akuzat-per-trafikim-armesh-kellici-te-nise-menjehere-hetim-parlamentar---i473579
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:28:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 14:18:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6f48fef2efe9d3fc640f2af0c5a14fbd11e52bc1226b39e62514157d7fc52624
TEKSTI	94ebbf895b6481db55e380e20265ab32a7d83551db24ad1c99f7642ec722bf03
PAMJA	e26a25f72b40e56bdda2236cb7cf92dbeb7cdcd268339ec5f92fa5ae0401146

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f3207d8593997d55d1bbc290be8ee06937c09c5297a5b9b30499275e1da94eb8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f3207d8593997d55d1bbc290be8ee06937c09c5297a5b9b30499275e1da94eb8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

21:06 Aktualitet

Plarent Ndreca ka zbuluar se ekziston një pushtet tjetër p...

Akuzat për trafikim armësh/ Këlliçi: Të nisë menjëherë hetim parlamentar ndaj ministrit Nufi



8 Shtator 2026, 16:18, Politikë CNA



Danuti dhe nënkryetari i Partisë Demokratike, Ralind Këlliçi, ka reaguar sot lidhur me akuzat e bëra nga ish-zëvendëskryemietri Arban Ahmeti ndaj Ministrit të Mbrojtjes, Ermon...

Edi Rama dhe Ermal Nufi, ish-zëvendëskryeministri Ahmetaj, solli dëshmi se si miku personal i Kryeministrit, izraeliti Ron Yeffet, në një komunikim me partnerët ukrainas tregoi se kishte çdo gjë nën kontroll në Shqipëri dhe mund të bënte çfarë të donte me procedurat, me tenderat, me projektet, me infrastrukturën.



Ahmetaj, akuza Nufit: Ministër Raketa, i përfshirë në trafikim të armëve

Përmes një postimi në rrjetet e tij sociale, Këlliçi shkruan se ndaj Nufit duhet të nisë në mënyrë të domosdoshme dhe të menjëhershme një hetim parlamentar për akuzën e trafikut ndërkombëtar të armëve.

Sipas demokratit, nevojitet transparencë dhe të jepet llogari lidhur me çështjen e armëve që do prodhoheshin në Afrikë e do ambalazhoheshin në Tiranë.

Këlliçi shton se Nufi duhet të kishte paraqitur dorëheqjen, ndërsa sot shfaqet sikur nuk ka ndodhur asgjë.

Reagimi i plotë:

Hetimi parlamentar për akuzën e trafikut ndërkombëtar të armëve, i domosdoshëm dhe i menjëhershëm!

Ndërkohë që Ministri i Mbrojtjes duhej të kishte paraqitur sot dorëheqjen dhe Kryeministri të mbante përgjegjësi e të jepte llogari për akuzën e shoqëruar me dëshmi për trafik ndërkombëtar të armëve, Edi Rama dhe Ermal Nufi u shfaqën në një aktivitet sikur asgjë nuk ka ndodhur.

Kujtojmë se mbrëmë, ish-zëvendëskryeministri Ahmetaj, solli dëshmi se si miku personal i Kryeministrit, izraeliti Ron Yeffet, në një komunikim me partnerët ukrainas tregoi se kishte çdo gjë nën kontroll në Shqipëri dhe mund të bënte çfarë të donte me procedurat, me tenderat, me projektet, me infrastrukturën.

Ai ishte pajtuar nga Kryeministri për të kryer punët e pisëta.

Dhe vegla që Ron Yeffet kishte në dispozicion në fushën e trafikut të armëve që do prodhoheshin në Afrikë e do ambalazhoheshin në Tiranë, është pikërisht Ermal Nufi

Ky është nga skandalet më të rënda të këtyre dekadave që çënon rëndë sigurinë tonë kombëtare por edhe të NATO-s, ku ne jemi anëtarë.

Ndërkohë që Edi Rama ka treguar se mbron çdo aferë e çdo person të përfshirë, dhe në kushtet kur SPAK nuk kryen detyrën, është e domosdoshme të ngrihet sa më shpejt Komisioni Hetimor Parlamentar që ka kërkuar sot Opozita.


Personalisht, kam kërkuar transparencë lidhur me këto dyshime dhe me aktivitetin e KAYQ, kompania shtetërore që ka krijuar Rama por që kontrollohet nga Ron Yeffet.

I kam dërguar kërkesë për informacion Ministrit të Mbrojtjes prej 5 muajsh, pa marrë asnjë herë asnjë përgjigje.

Kjo heshtje konfirmon akuzën që u bë mbrëmë dhe dëshmisë që u bë publike për trafik ndërkombëtar armësh.

Parlamenti e ka për detyrë të hedhë dritë mbi këto fakte, dëshmi e akuza.

Me nisjen sot të sesionit të ri parlamentar, duhet të marrë rrugë edhe kërkesa e drejtë e Opozitës për ngritjen e Komisionit Hetimor Parlamentar për këtë mega skandal!!CNA





Të sugjeruara

[“Zjarret nuk shuhen me propagandë”/ Grigels Muçollari: Rama duhet të japë llogari për dështimin në këtë sezon](#)

[Çështja e pagave të drejtësisë/ Balla zbulon datën: Ja kur do të shqyrtohet nga parlamenti](#)

[Përplasjet me Edmond Spahon/ Noka: PD i ka dhënë shumë atij](#)

["Do të kemi dhe shumë lajmë të tjera"/ Noka zbulon detaje për vizitën e Berishës në SHBA](#)

[Shpallja non grata e Berishës/ Noka zbardh debatin me Luli Bashën](#)

[Prapaskenat e takimit Rama-Soros/ "Lirimi" i Veliajt, në qendër të diskutimeve](#)

[Noka: Zyrtarët e lartë janë arrestuar falë fakteve që ka sjellë PD-ja](#)

[Akuzat e Ahmetaj për trafik armësh/ Noka ngre alarmin: Siguria në dorë të një grupi](#)

mafiozësh

"Ripërtëritja nuk ka përfunduar"/ Noka e zbulon: Ja çfarë do të ndodhë me PD-në në vjeshtë

Kur bie Rama?

"Regjimet nuk munden kurrë me votë"/ Noka: Sot gjenerata Z është në protestë

"Nëse mbahen zgjedhje të lira, Rama nuk fiton përballë PD-së"/ Noka: Sot, parti e parë për vota janë bandat

Sulmet ndaj PD/ Flamur Noka: U bë luftë e ethshme nga pushteti për ta kapur

"Skandali i trafikut të armëve"/ Këlliçi: Rama dhe Nufi të dorëhiqen, SPAK të nisë hetimet

"Mirëseardhja në Tiranë"/ Rama zhvillon takim me ambasadoren e re të BE-së

Varrimi i Ratko Mlladiç/ Berisha: Mbështetja e hapur për gjenocidin nga Vuçiç, sfidë ndaj qytetërimit

Vizita në SHBA/ Berisha zhvillon takim me kongresmenin Keith Self

Nisma "Prania Besnike"/ Zaganjori: Garda e vjetër e PS nuk bëhet makiazhi propagandistik i Ramës


Sot, seanca e parë e sesionit të ri parlamentar/ Jashtë Kuvendit pritet protestë


Deklaratat e Ahmetaj për trafikun e armëve/ Këlliçi: Hetime të menjëhershme nga SPAK
[editorial](#)

17:34 Editorial

Pse Gjykata e Lartë nuk duhet ta lirojë nga burgu Erion Veliajn?

CNA LIVESTREAM





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.